

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas*

(II ad Cor. III, 17-)

---

1. Mâ i mrâmi apel.	Fq. 97
2. „Boy Scouts“ në Shqypni.	„ 104
3. Mbi Ortografi të sotshme.	„ 112
4. Grueja Shqyptare (Rromanzë).	„ 118
5. Dante Alighieri 1321-1921.	„ 122
6. Shaureti.	„ 128
7. Lajme.	„ 136
8. Bibljografi.	„ 143



# HYLLI I DRITËS

Vjeta II.

KORRIK 1921

Num. III.

## Mâ i mrâmi apel.

S.THOMAS. 2. 2. q. 89, 1. 2. q. 107; SUAREZ. De Religione Tract. 5; GOEP. FERD. Der Eid; DICASTILLO. De Juramento; OJETTJ. Juramentum; SPORER-Bierbaum. Theol. mor. dec. trac. 3. BOUQUILLON. De virtute religionis p. III.

Mungesa e mjeteve të mjaftueshme për me e njoftë të verteten gjithherë e me suguri, kje e kà me kë në për nieri një nevojë, të cillen nuk do të mund e plotsojë kryekput as me hollë të mendes, as me vullnesë të mirë, as me mundë të krahve. E për njoftsija e sugurtë e kafshve për nieri është aq e nevojshme sà është këna e tyne. Po, ruena zot, me pasë për të mrrijtë nierzimi me u lidhë e me u perkundë mrenda një skepticizmit të plotë, at herë mos e pvet hallin e nierit: po nuk muejtem na me kë në të sugurë jo mâ për fuqë, për virtyt, për tagre e detyrë t'ona, por as për kë në t'ona, aq mâ pak kemë me ja pasë besen kë nës e veprimt të kafshve tjerë. Shoqnija nuk kishte me kë në tjetër por një trillim fantaziet, një fjalë për t'u folë, auktoriteti kish' me kë në një marrë; kuer fmia mos të mund të jenë i sugurtë për prind, as nenshtetasi për të parë, hiqi vizë familjes e shoqnis, e bota kishte për të kë në një shkretë mrenda së cilës kishin me u lnduer e me u grë njato bishë qi kishin me kë në nierzt. Por jo, natyra është nânë, e sado qi nuk ja çili nierit perden për me njoftë gjithshka, nuk i la gjà të mangët për njofts të nevojshme, „natura in necessariis non deficit:“ mendes së nierit i dhà fuqin të muejte me e njoftë të verteten, jo vetun dosido, por me suguri; vullnesen e drejtoj në mëndyrë qi mos të muejte me dashtë tjetër për posë të vertetët, „nil appetitur nisi sub ratione veri;“ e në ndimë të ktyne dy fuqive, me një bindë të pashoqe rendoj një morë fuqish niesore e bimorë, e gjith kta e bânë vetun për me ju gjetë nevojve të nierit, perse „natura nil frustra molitur“, natyra kurr nuk vepron kot. Prandej

